VENDIM
Nr.90, datë 3.12.2009

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE TË OSSH SHA PËR VITIN 2009 - 2010

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 11 të rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 2.12.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OSSH sh.a. dhe u njoh me informacionin e përgatitur nga grupi i punës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2009 – 2010,

konstatoi se:

Aplikimi i OSSh sh.a. për planin e investimeve për vitin 2009 dhe 2010, në përgjithësi, është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 13 të rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike. Gjithashtu Bordi i Komisionerëve vëren se, përsa i përket pjesës së plotësimit me matësa të të gjithë konsumatorëve, konstatohet se ky detyrim nuk plotësohet brenda afateve të paraqitura në këtë plan investimesh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e investimeve të OSSH sh.a. për vitin 2009 – 2010.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta